

Zyrës për Doktoraturë te Universitetit të Tetovës
Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit Filozofik

Këshilli mësimor-shkencor i Fakultetit Filozofik të Universitetit të Tetovës në mbledhjen, e mbajtur më **14.11.2024** solli Vendim për formimin e Komisionit për vlerësimin shkencor dhe profesional e dorëshkrimit të temës së doktoraturës me titull: "**NDIKIMI I FILOZOFISË ISLAME NË NDËRTIMIN E MENDIMIT QYTETËRIMOR SHQIPTAR**" i kandidatit **Mr. Ramazan Fetahu**.

Në bazë të vendimit 16-950/2 të datës 14.11.2024, Komisioni i përbërë nga: **Prof. dr. Kushtrim Ahmeti** (kryetar), **Prof. dr. Sulejman Baki**, **Prof. dr. Adnan Ismaili**, **Prof. dr. Qani Nesimi** (anëtarë) dhe **Prof. dr. Metin Izeti** (mentor), pasi analizoi materialin në dorëshkrim, Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Tetovës, i paraqet këtë:

RAPORT

për vlerësimin e disertacionit të doktoraturës

Të dhënrat biografike për kandidatin

Ramazan Shukri Fetahu është i lindur më datë 03.08.1993, në fshatin Kuk, komuna e Dragashit, Kosovë. Shkollën fillore e kreua në vendlindje në vitet 2000-2009. Kurse të mesmen në medresenë Alauddin në Prizren, në periudhën 2009-2013. Studimet Universitare në drejtimin e Teologjisë, i vazhdon në Tiranë, në periudhën 2013-2016, ku diplomohet dhe merr titullin "Bachelor në Shkenca Islame". Në cilësinë e temës së diplomes e ka trajtuar temën: "*Rrymat ideore fetare Islame në Shqipëri në fillim të shek. XXI*". Më pas, 2016, vazhdon studimet master në Filozofi, në universitetin e Tiranës, fakultetin e Shkencave Sociale, drejtimi: Filozofi Sociale. Diplomohet në vitin 2018, me tezë: "*Filozofia morale e Farabiut: analizë krahasuese mes Aristotelit dhe Farabiut*" dhe njëherit merr titullin "Mr.sc" në "Filozofi Sociale".

Në vitin akademik 2018-2019, regjistrohet në studimet doktoraturë në Universitetin e Tetovës, fakulteti Filozofik, program: Shkenca mbi gjuhët, drejtimi Filologji Orientale.

Gjatë kësaj kohe, ka marrë pjesë në konferenca shkencore, brenda dhe jashtë universitetit të Tetovës. Aktualisht punon si Imam-ligjerues në Bashkësinë Islame të Kosovës, dega në Dragash. Është i martuar dhe ka një fëmijë.

Pasqyrë e aktiviteteve të realizuara nga kandidati gjatë studimeve të doktoratës

Kandidati Mr. Ramazan Fetahu që nga fillimi i studimeve në ciklin e tretë të doktoraturës e këndej, ka dëshmuar interes dhe progres të kënaqshëm në fushën e hulumtimit dhe të punimit të disertacionit të doktoraturës. Ai me sukses ka realizuar tri konferencat doktorale, gjatë të cilave ka prezantuar rezultatet e hulumtimit. Gjatë kësaj periudhe ka botuar punime, artikuj shkencor në revista ndërkombëtare të fushës dhe ka marrë pjesë në disa konferenca shkencore vendore dhe ndërkombëtare.

Punimet e tij gjatë kësaj periudhe janë:

1. “Ecja Ime” (libër me poezi), Prizren 2012.
2. “Filozofia Morale e Farabiut, Sh.B. Fleta, Prizren 2019.
3. “Etika filozofiko-religjioze e Mevlana Xhelaludin Rumiut”, rev. Philosophica, nr 17, viti 2022
4. “Sfondi estetik në poemën ‘Dashuria’ (eros) të Naim Frashërit”, rev. Univers. Nr 21. Viti 2020
5. “Mendimi filozofik oriental dhe zgjatjet e tij në konceptet postmoderne”, rev. Univers., vitit 2023.

Analizë e disertacionit të doktoraturës

Disertacioni i doktoraturës me titull: “**NDIKIMI I FILOZOFISË ISLAME NË NDËRTIMIN E MENDIMIT QYTETËRIMOR SHQIPTAR**” i kandidatit **Mr. Ramazan Fetahu** përbëhet nga Hyrja, gjashtë kapituj, Përfundimi dhe Rekomandim; si dhe Bibliografia.

Në pjesën e **Hyrjes** kandidati ka paraqitur ecurinë e filozofisë islame në kuadër të mendimit të përgjithshëm qytetërimor duke theksuar se mendimi filozofik islam është zhvilluar në kuadër të këtyre elementeve:

1. Ndiqimit të Kur'anit i cili në shumë vende dhe mënyra e thirr arsyen njerëzore të mendojë/meditojë;
2. Ndiqimi i kulturave të huaja të cilat vinish përmes pranimit të fesë islamë nga popujt e ndryshëm;
3. Ndiqimi i filozofisë greke e cila hyri përmes përkthimit të librave të Aristotelit në gjuhën arabe.

Nën ndikimin e këtyre faktorëve dhe nën hijen e shpalljes filloj ngadalë të marrë formë mendimi islam. Duke qenë i tillë, marr guximin të them se brenda shkollave islamë, ai u shtri në 3 shkenca: kelam (apologjetikë), filozofi, dhe tesavvuf (misticizëm). Duke i qëndruar besnik përherë fjalës së shpallur, arsyja dhe teksti kanë ecur paralel me njëri-tjetrin. Kjo strukturë e mendimit ka qenë baza e asaj që mund të quhet 'mendim islam' klasik.

Shekulli XVII, XVIII, kur në Europë po lulëzonte iluminizmi, tek muslimanët ende diskutoheshin çështjet 'klasike' filozofike. Kjo jo përfaktin se kishin mbetur mbrapa në aspektin e mendimit, por përfaktin se tek mendimi filozofik islam nuk ka ndryshime radikale, nuk ka epoka të mendimit, apo ndryshim të trajktoreve, në islam mendimi është linear, i qëndrueshëm, konstant i bazuar në premisat universale të cilat janë imananca e vlerave primordiale. Temat kryesore: Zoti, bota dhe njeriu, janë struktura e përgjithshme dhe dominante të cilat e udhëheqin mendjen njerëzore nga epoka në epokë.

Tematikat të cilat janë diskutuar në botën islamë në tërësi, por edhe disa nga problemet sociale të diskutuara në Perëndim i kemi identifikuar edhe në analizën konceptuale të poetëve shqiptar, konkretisht te bejtexhinjët dhe ata të rilindjes kombëtare. Kjo më ka bërë motivues në kërkimin e 'vizionit të tyre intelektual dhe politik' në raport me ekvivalentët e tyre në Lindje dhe Perëndim.

Brumi i përgjithshëm i formimit të tyre intelektual korrespondon me strukturën e ofruar nga "bejtu'l-hikmeh". Përtej dogmatizimit të mbyllur, dhe përtej indoktrinimit të verbër është formuar mendimin i poetit Shqiptar – këtu me theks të veçantë dua ta përmend Naim Frashërin. Naimi në mes 'ndikimit' të revolucionit francez në njérën anë dhe ndikimit të filozofisë orientale, (konkretisht mësimet e Rumiut) është formuar "Naimi i Shqiptarëve", që shërben si prototip i studimit tonë. Sikurse e thotë edhe akademik Rexhep Qosja, 'Në

filozofinë e tij (Naimit), nëse mund të quhen kështu persiatjet e tij të pasistem, shihen të gërshetuara ndikesa të të dy këtyre sferave të kulturës botërore: të kulturës klasike greke e persiane – arabe, nga njëra anë dhe të kulturës moderne franceze, nga ana tjetër’.

Përmes punimit të tij kandidati është munduar të kap në themel konceptet filozofike islame dhe orientale që hasen në poezinë shqipe, dhe më pas shpjegimin dhe arsyetimin shkencor duke i vendosur në vendin përkatës të tyre në klasifikimin universal të vlerave.

Në vija të trasha – Një kërkim i mirëfilltë filozofik ndaj një çështje si zakonisht fillon me Epistemologjinë - natyrën e dijes-qasjes ndaj saj, dhe vazhdon me Ontologjinë - respektivisht mendimin e saj për qenien, dhe më pas vjen koncepti i saj mbi botën ose Kozmologjia. Në vazhdim është Etika si ‘gjetje’ dhe vendosje e ‘Vetës’ në botë, dhe vendosja e rendit mbi të. Mënyra e vendosjes dhe shijes ka të bëjë me Estetikën, dhe në fund Qytetërimi është vizioni dhe modeli tërësor i krijuar mbi botën që i ofrohet botës.

Kandidati është munduar të ndjek pak a shumë këtë metodologji shkencore edhe e ka ndarë punimin në 6 kapituj: Epistemologjia, Ontologjia, Kozmologjia, Etika, Estetika dhe Dashuria, Qytetërimi.

Në **kapitullin e parë**, është diskutuar “Epistemologjia Islame” me përqëndrim të veçantë në mendimet e poetëve shqiptar. Fillimisht është analizuar problemi dhe natyra e ‘dijes’, në kontekstin islam dhe më pas jemi fokusuar tek disa nyje ndërtuese të asaj që e kemi emëruar Epistemologjia Islame.

Tek ‘dija’ sipas Islamit, rolin kryesor e luan ‘Shpallja’ (vahji), në bazë të derivateve të shpalljes janë formuar edhe shkencat islame më pas. Pikërisht rreth konceptit të shpalljes e kemi analizuar konceptin e hfx Ali Korçës mbi ‘shpalljen’.

Në **kapitullin e dytë**, në kuadër të ontologjisë, e kemi analizuar konceptin e Vahdeti vuxhdudit (Njëshmërisë së qenies dhe ekzistencës). Analizën e kemi orientuar në dy drejtësimë: Së pari, çfarë është “v ahdet-i vuxhudi” si koncept filozofik dhe sufik, duke i parashtruar argumentet tradicionale dhe racionale me të gjitha elementet e saj, më pas ndarjen e vahdet-i vuxhdudit nga vahdeti shuhudi dhe duke i paraqitur ngashmëritë dhe dallimet mes tyre. Dhe së dyti, kemi trajtuar konceptin e vahdeti vuxhudit në raport me projekcionet tjera teologjike dhe filozofike rrith çështjes së natyrës së Zotit. Në këtë mënyrë e kemi përcaktuar ‘vendin’ e

vahdeti vuxhudit në kontekstin e Shqiptarëve. Si shembull më tepër jemi shërbyer me Naim Frashërin dhe hfz.Ali Korçën.

Në **kapitullin e tretë**, në cilësinë e kozmologjisë – e kemi shijelluar konceptin e ‘Nurit (hakikatit) Muhamedije’. Drita (nuri) i Muhamedit a.s. është koncept i njohur në teozofinë dhe sufizmin islam. Analizën e kemi drejtuar në tre kahje: Së pari, ‘drita’ e Pejgamberit a.s. është konceptuar si zanafillë dhe origjinë e krijimit. Çdo gjë është krijuar nga Drita dhe drita e parë e krijuar është drita e Muhemedit a.s. sikurse ka thënë Muhamedit a.s.: “Gjëja e parë që ka krijuar Allahu është drita ime”. Së dyti, të qenit i pari në aspektin e ekzistencës ‘Nuri Muhamedije’ është konsideruar edhe si zanafillë e Pejgamberisë. Koncepti dhe institucioni i Pejgamberisë fillon me Pejgamberin Muhamedin a.s.. Në lidhje me këtë Pejgamberi a.s. thotë: “Ne jemi të parët dhe të fundit” . E kemi analizuar edhe ‘Mevludin’ si manifest i dashurisë ndaj Muhemedit a.s, dhe Mevludin si kulturë. Së terti, Drita (nuri) e Muhemedit është esenca e konceptit të ‘insanu kamil’ (njériut të përsosur). Insani Kamil është konsideruar njeriu i plotë i cili e ka realizuar vetën. Shembull kemi marrë konceptin e bejtexhinjëve për këtë çështje, në mënyrë të veçantë Sheh Mala, Shejh Jonuzi, Nezim Frakulla.

Kapitulli i katërt, merret me konceptin e Etikës dhe Edukatës islame. Edukata konsiderohet rregulli, rruga e cila e dërgon njeriun te etika, kurse etika është vendi dhe sjellja e njeriut në raport me botën. Kur themi në raport me botën kemi parasysh të vëmë në pah, se etika islame nuk kufizohet vetëm tek njeriu por e tejkalon njeriun dhe është rregull universal që synon t'i vë rend botës. ‘Zoti na e dha mendjen ta kuptojmë të mirën’ - thoshte Naim Frashëri, ku në bazë të saj ndërlidhet teologjia, epistemologjia dhe etika. Etika e tillë synon ta ndërtojë një ‘Njeri religjioz-etik’. Shembulli i ‘Ervehesë së Muhamet Çamit’ dhe ‘Besa’ e Sami Frashërit janë dy modele të shqiptarit etik dhe religjioz, të cilat i kemi marrë në shqyrtim. Përmes këtyre dy shembujve jemi munduar të zbresim në thellësi të gjenit shqiptar për ta kapur më mirë vizionin e tij etik për botën.

Në **kapitullin e pestë** bëhet fjalë për ‘Estetikën dhe Dashurinë’. Këto dy koncepte lidhen me njëra-tjetrën pasi se botërisht dihet se ‘e bukura’ e dërgon njeriun te dashuria’.

Estetika është shkenca e cila merret me të bukurën. Në kuptimin e vërtetë të fjalës, ‘Bukuria’ absolute është bukuria e Allahut xh.sh. dhe çdo gjë tjeter që e shohim si të bukur është shpërfaqja e bukurisë absolute. Të bukurën e kemi ndarë në dy grupe: e bukura e jashtme dhe

e brendshme. Sa i përket bukurisë së jashtme ajo është buuria e cila përceptohet përmes shqisave, kurse buuria e brendshme ka të bëjë me formimin etiko-estetik të karakterit të njeriut. Nuk mund të jetë i bukur një njeri me karakter të keq. Dhe, ja, mu këtu tek 'bukuria e brendshme' bëhet lidhja e etikës me estetikën. Shembuj të kësaj bukurie janë: Jusufi a.s. dhe Erveheja heroina shqiptare e moralit (raste këto të cilat i kemi trajtuar në punim).

Sa i përket dashurisë, edhe atë e ka ndarë në dy lloje: Dashuria e vërtetë (hakiki) dhe Dashuria alegorike (mexhazi). Dashuria e vërtetë është dashuria që i kuashitet ekskluzivisht Allahut xh.sh., që në letërsinë dhe filozofinë sufike është emërtuar si 'ashk', kurse dashuria alegorike është dashuria ndër-njerëzore e cila në fund të fundit të çon tek dashuria e vërtet (hakiki). Dashuria e Mexhnunit ndaj Lejlës, në fakt ishte dashuri ndaj Zotit xh.sh. Fuzuli përmes përshkrimit të Lejlës i përshkruan cilësitë e Allahut xh.sh..

Si shembull ka marrë Jusufin dhe Zylejhjanë, sipas verzionit të Hfz. Ali Korçës – ku në fund të ngjarjes Zylejhaja martohet me Jusufin a.s. dhe e 'derdh' dashurinë alegorike tek dashuria e vërtetë. Realisht destinacioni i saj final ka qenë arritja te Zoti, përmes Jusufit a.s.. Gjithashtu, shembull tjetër të dashurisë alegorike kemi marrë veprën "Dashuria e Talatit me Fitnetin" të Sami Frashërit duke e krahasuar me "Lejlën dhe Mexhnunin" e Fuzuliut.

Në **kapitullin e gjashtë** analizohet koncepti i 'Qytetërimit'. Së pari, në aspektin etimologjik dhe terminologjik dhe më pas në aspektin konceptual në Islam dhe në botën perëndimore. Tek analiza jemi marrë me origjinën e qytetërimit sipas perëndimorëve, evoluimin dhe qëllimin e tij final. Më pas kemi analizuar konceptin e 'medenijetit' dhe shtrirjen e tij tek mendimtarët musliman.

Si shembull është marrë koncepti i qytetërimit islam tek Sami Frashëri dhe hsz.Ali Korça. Samiu, ndoshta me një mendje moderniste, mbron mendimin se Islami ka gjeneruar një qytetërim origjinal me veçoritë e tij dalluese nga qytetërimet tjera. Ai mbron idenë se përkundër të gjitha gjérave, Islami e zotëron një fuqi brenda e cila ka mundësi ta ngritë përsëri një qytetërim universal.

Kurse hsz. Ali Korça duke e bërë një ndarje në mes qytetërimit mjeshtëror (perëndimor) dhe qytetërimit të vërtetë (lindor), ai mundohet ta ofrojë një alternativë orientuese dhe shpëtuese të qytetërimit shqiptar. Ai përmend shembullin e Japonisë e cila nga perëndimi mori mjeshtëritë por kulturën, traditën, zakonet, fënë i ruajti.

Në pjesën e **Përfundimit dhe Rekomandimeve** kandidati konstaton se një prej elementeve më të rëndësishme dhe më me afat të gjatë në ndërtimin e identitetit kulturor dhe qytetërimor të shqiptarëve padyshim është spektri i fesë islame dhe mendimit islam. Feja islame dhe kultura e mendimit islam kanë ndikim të dukshëm edhe në mendësinë shqiptare pas tërheqjes së Shitet Osman nga trojet shqiptare dhe veçanërisht në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore. Vitet pas pavarësisë së Shqipërisë kanë qenë përplot me sfida dhe lëvizje mendore andej këndej me qëllim që të konsolidojnë qasjen qendore të zhvillimit kulturor dhe qytetërimor të shqiptarëve në konceptologjinë e botës së re. Si rrjedhojë, siç është e pasqyruar edhe në shtypin ditor, atë periodik dhe në literaturën e botuar krahas ndikimit të Oksidentit, që konsiderohet si e re dhe promovohej me ngulm, në anën tjetër ndikim të madh ka pasur edhe mendimi dhe filozofia islame e cila është manifestuar në dy segmente kryesore:

1. Në tekstet fetare të periudhës ndërmjet dy luftërave botërore,
2. Në poezinë e bejtexhinjve, e cila drejtëpërdrejt ishte e ndikuar nga filozofia islame dhe tesavvufi.

Mirëpo krahas kësaj, ne si shqiptarë në periudhën e mëvonshme jemi ballafaquar me një injorim total dhe marginalizim selektiv të ideve orientale të cilat kanë ndikuar në letërsinë dhe mendimin qytetërimor shqiptar deri në ditët e sotit. Pikërisht ky ishte shkaku dhe sfida kryesore që në bashkëpunim me mentorin na udhëhoqi për të zgjedhur një temë të tillë si disertacion të doktoratës.

Në hulumtimin e raportit ndërmjet krijintarisë së autorëve të ndikuar nga filozofia dhe mendimi islam dhe krijimi i një letërsie shumë të pasur ky studim niset nga analiza e dialogut ndërtkstual që poezia e shkruar me alfabet arab në gjuhën shqipe, vendos me traditën letrare të cilës i përkiste Edhe pse synohej poetika e letërsisë së rrëthit orientalo-islam duke afirmuar dhe riprodhuar tekste tashmë ekzistuese, domethënë, të ushqyer nga ideja e pranishme në tekstet dhe poezitë e tesavvufit islam, vetëdija për këtë ishte e ndryshme dhe lëvronte që nga ngjarjet shoqërore e deri në çështjet më të komplikuara ontologjike dhe epistemologjike.

Duke e vëzhguar veprën e letërsinë e shkruar nga autorët shqiptar nga këndvështrimi i sotëm, lind problemi i pritjes, i cili mund të shihet nga dy aspekte. Përkatësisht, nuk ekziston vetëm problemi i të kuptuarit të gjuhës së huaj dhe arkaike, sistemi i veçantë i simboleve, motiveve, aludimeve dhe reminishencave që lindën si rezultat i ndryshimit të mjedisit sociokulturor, por edhe problemi i të kuptuarit të mënyrës se si vetë ata e kanë perceptuar traditën letrare orientale-islame në veprat e tyre. Natyrisht, ky problem nuk është diçka specifike vetëm për

receptimin e teksteve shqiptare në gjuhën osmane , por mund të shihet shumë më gjërësisht, si çështje e perceptimit dhe kuptimit të sotëm të letërsisë së divanit në përgjithësi. Ahmet Hamdi Tanpinar (1901–1962), një nga shkrimtarët dhe kritikët letrarë më të rëndësishëm turq të shekullit të 20-të, ishte ndër të parët që problematizoi pritjen e letërsisë klasike osmane në shoqërinë moderne turke. Tanpinar beson se poezia e vjetër ka ligjet e veta që ishin të njoitura përmarrësin në atë kohë. Duke qenë se konteksti i poezisë së vjetër ka humbur me kalimin e kohës, loja e fjalëve dhe e kuptimeve është bërë e largët për lexuesin modern, me të cilin ky autor identifikohet me këto fjalë: "Megjithatë, sot kjo lojë është e huaj për ne, çdo lojë ka marrëveshjen e saj të fshehtë, nëse kjo marrëveshje nuk arrihet, është fare e sigurt që poezia nuk do të na pëlqejë dhe do ta shohim qesharake dhe artificiale".

Zhvillimet e fundit në arenat kulturore botërore janë në drejtim të rileximit të traditave pereniale të popujve të ndryshëm. Shembuj të shumtë kemi në kinematografinë e ditëve tona, madje edhe shumica e filmave të tillë që ngjiten për revitalizimin e ideve gjenerative të popujve të ndryshëm fitojnë çmimet kryesore në festivalet e filmit.

Koncepti i ri i multukulturalizmit botëror nuk është më i përqendruar në reduktimin e dallimeve, siç e promovonte globalizmi, por në bashkëjetesën e dallimeve dhe pasurimin e shoqërisë me lule të ndryshme të sjella nga hapësira të ndryshme. Këta lule kulturore ne i kemi të pranishme në trashëgiminë tonë kulturore shqiptare dhe duhet t'i kultivojmë dhe të bëjmë rileximin e tyre kritik.

Shumëdimensionaliteti i identitetit shqiptar, në një botë të globalizuar, reflektohet edhe në identitetin personal të individëve në një mënyrë të tillë që i njëjti person, tanë, në nivelin e identitetit të tij, duhet të "pajtojë" përzierjen edhe me konceptet e reja e mos të diskutojmë ata që janë tradicionale dhe të trashëgura. Si pasojë, multikulturalizmi, në këtë kontekst, është përgjigje për dejustifikimin e politikës së asimilimit, në dritën e nevojës për të ruajtur diversitetin kulturor.

Në aspektin qytetërimor (dhe kombëtar), nuk duhet të operojmë me të vërteta të cilat i kemi bërë 'të amshueshme', por duhet të udhëhiqemi nga vlera amshueshmërisht të vërteta. Kur kemi diskutuar në kapitullin mbi ontologjinë kemi thënë se: Në çdo kriesë Zoti ka një përfaqësim të veçantë. Për nga natyra e tij e amshuar, ajo kërkon pluralitetin, ndryshueshmërinë e paraqitjes së trajtave të tij në kozmos. Andaj secili popull i vënë në botë për nga aspekti ontologjik, gjeografik por edhe psikologjik – i mbart në gjenin e vet të gdhendura specifikat primordiale me të cilat do ta plotësojë vetën. Thënia e Pashko Vasës:

"Oj Shqipëri mos rri, po duku", simbolizon në një farë forme këtë që e themi. Duke qenë se Shqipëria ka qenie d.m.th. "është", atëherë duhet t'i japë zë kësaj esence-qenie, ta hedhë në ekzistencë atë. Dhe kjo ekzistencë e hedhur është përqendrimi ontologjik, kulturor i një populli apo kombi. Kjo shpërfaqje formon qytetërimin original të popullit të caktuar. Kultura dhe qytetërimi janë koncepte metafizike të cilat kanë të bëjnë me jetën shpirtërore morale të njeriut. Duhet të udhëhiqemi nga aksilogjia e vlerave të përjetshme të cilat vijnë në përputhje me elementin tonë si shqiptar të gjendur gjeografikisht në pjesën e Ballkanit.

Në mendimin islam, koncepti i qytetërimit do të thotë 'medenijet' - që do të thotë qytet. Sipas këtij koncepti, qytetërimi, qyteti dhe feja kanë një lidhje organike. Është një themel besimi dhe morali që qëndron në themelin e strukturës shoqërore. Prandaj, ai, jo domosdo nënkupton edhe sistemin politik. Islami në mënyrë të drejtë përdrejtë nuk lidhet me politikën, por pjesë e tij mund të jetë edhe politika.

Në mënyrë konkrete, Branko Merxhani dhe Hafiz Ali Korça kanë formuar një shabllon orientues të qytetërimit shqiptar. Sipas Branko Merxahnit, janë të ndara, kultura dhe qytetërimi. Në aspektin e kulturës, traditës dhe zakoneve, njeriu mund të ketë kulturën e tij, kurse raporti i tij me sferën publike ka të bëjë me qytetërimin e tij. Kurse hafiz Ali Korça duke i ndarë qytetërimet si: qytetërimi i vërtet dhe qytetërimi mjeshtëror – sjell një perceptim të ri orientues shqiptar. Përmes shembullit të Japonisë, e cila nga Perëndimi mori teknologjinë kurse për brenda i ruajti zakonet e veta tregon një shembull se e dhe kombi shqiptar mund ta realizojë këtë mesatare.

Si përfundim kandidati thotë se ky 'komb në udhëkryq' për tu zhvilluar kërkohen po ato dy elemente të përmendura në krye të herës: Vetëdijken dhe Lirinë. Me vetëdije nënkuptojet vetëdijken njëherë ontologjike si bartëse e emanetit, si proces për ta përbushur dhe plotësuar vetën, pastaj edhe vetëdijken historike e cila lidhet tanë me zhvillimet qytetërimore dhe politike globale. Dhe, së dyti, Lirinë. Liri do të thotë mos-varje nga askush, autonomi, mos shtrëngim. Në mënyrë eksplikite lidhet me zhvillimin së pari kulturor e më pastaj edhe ekonomik. Vetëm atëherë do të plotësohet 'emaneti' hyjnor.

Gjithashtu do të ishte edhe një përgjigje ndaj realitetit etno-kulturor të ndërlikuar nga proceset e globalizimit, me fjalë të tjera pranimi i konceptit sa më të gjerë të spektrit i cili do të njihte realitetin e bashkëjetesës së dallimeve, jo vetëm ndërmjet grupeve të ndryshme sociale, por edhe në kuadër të identitetit të njëjtë etnik, fetar dhe kulturor.

Në pjesën e **Bibliografisë** janë rradhitur në bazë të rendit alfabetik të gjitha burimet dhe literature e konsultuar nga ana e kandidatit.

Përshkrim i shkurtër i metodave të përdorura

Gjatë hartimit të punimit të doktoraturës me titull “**NDIKIMI I FILOZOFISË ISLAME NË NDËRTIMIN E MENDIMIT QYTETËRIMOR SHQIPTAR**”, kandidati është mbështetur dhe ka respektuar teorinë shkencore dhe metodologjinë e punës kërkimore-shkencore. Janë shfrytëzuar disa metoda shkencore, si, përshkrimi, analiza e përbajtjes, krahasimi dhe kriticizmi. Për shkak të natyrës së punimit, ndarja është bërë sipas tematikës, çdo nëntemë është e lidhur me njëra-tjetrën.

Kandidati për përgatitjen e punimit ka shfrytëzuar kryesisht burimet autoriale të autorëve, vepra shkencore të botuara, monografi, zëra enciklopedikë, punime shkencore nga revista të ndryshme, literaturë të përgjithshme kryesisht në gjuhën arabe, turke, boshnjake, angleze dhe në gjuhën shqipe.

Përshkrimet, analizat, krahasimet dhe kritikat janë bërë në bazë të metodologjisë së mirefilltë shkencore dhe si rrjedhojë mund të shërbejnë si një dokument dhe provë e veçantë në punimet e mëtutjeshme për temën në fjalë.

Përshkrim i shkurtër i rezultateve të hulumtimit

Rezultatet kryesore të disertacionit të doktoraturës me titull: “**NDIKIMI I FILOZOFISË ISLAME NË NDËRTIMIN E MENDIMIT QYTETËRIMOR SHQIPTAR**”, mund të rezimohen si më poshtë:

Pasuria shumë e vlefshme e arkiveve dhe bibliotekave shqiptare nuk është e evidentuar si duhet dhe nuk është digitalizuar, mosekzistimi i projekteve për zbulimin e dorëshkrimeve që janë në pronë të individëve dhe institucioneve shoqërore që kanë pasur akces të rëndësishëm në shoqerinë shqiptare gjatë shekujve. mosidentifikimi dhe moskokonzervimi i dorëshkrimeve me vlerë shkencore dhe estetike, qasjet reduktive dhe me standarde të dyfishta në lidhje me trashëgiminë e shkruar në periudhat e kaluara ndikojnë dukshëm në varfërinë e paraqitjes së traditës kulturore shqiptare. Situata nuk është më e mirë edhe në monumentet kulturore historike që e mbajnë vulën e periudhave të ndryshme kulturore-historike në të

cilat është ndërtuar gjeni shqiptar. Fjala është për xhamitë, kishat, tejetë, manastiret, urat, çarshitë e vjetra, hamamet dhe të ngjashme.

Gjendja është, pak a shumë, identike në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut. Institucionet që duhet të angazhohen në ruajtjen dhe kultivimin e kësaj trashëgimie, duke treguar shkaqe të ndryshme që nuk mund të konsiderohen fare si arsyetime, janë të përqendruara kryesisht në projekte individuale dhe aspak, ose shumë pak, janë të interesuar për ndërtimin e politikave kulturore të cilat do të ndihmojnë në rigjallërimin e trashëgimisë tonë të pasur kulturore.

Institucionet kulturore, pashmangshëm, duhet të kryejnë punën administrative dhe veprimet që kanë të bëjnë me: kërkimin, studimin, monitorimin, regjistrimin, dokumentimin, valorizimin dhe promovimin e trashëgimisë kulturore; gjithsesi duhet të funksionojë si duhet shërbimi qendror i informacionit dhe dokumentacionit i digitalizuar; përcaktimi i pronave të mirave kulturore të mbrojtura. Më pas, të përqendrohet në kujdesin, koordinimin dhe mbikëqyrjen e financimit të programeve për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore; themelimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve për kryerjen e veprimitarive për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore; vlerësimin e kushteve për punën e personave juridikë dhe fizikë në punët kulturore; restauruese, konservuese dhe të tjera për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore; sigurimin e kushteve për edukimin dhe aftësimin e punëtorëve profesionistë në fushën e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore; zbatimin e mbikëqyrjes së trafikut, importit dhe eksportit të mallrave të mbrojtura kulturore; përcaktimin e kushteve për përdorimin dhe qëllimin e të mirave ndërtimit për mbrojtjen e pjesëve të trashëgimisë kulturore; kryerja e punës inspektuese për mbrojtjen e trashëginiisë kulturore.

Të sipërpërmendurat e paraqesin skeletin e ruajtjes së trashëgimisë kulturore shqiptare, ndërsa më pas vijon rileximi sociokritik të trashëgimisë së përgjithshme të trashëgimisë kulturore shqiptare.

Qëllimi kryesor i rielximit socio-kritik të trashëgimisë kulturore është vizioni për të kaluarën në mënyrë racionale dhe objektive, në mënyrë të tillë që të kapërcehen të gjitha idetë kufizuese prej saj. Kjo çështje nuk është diçka e re në botë, ajo u promovua kryesisht nga e ashtuquajtura Shkolla e Frankfurtit, eksponentët kryesorë të së cilës ishin, ndër të tjera, Theodor Adorno dhe Max Horkheimer.

Studimi mëton ti ngërthejë qëllimet si më poshtë:

- Konceptet filozofike dhe kategoritë e mendimit qytetërimor në krijimtarinë 4 autorëve shqiptarë të ndikuar nga filozofia islame.
- Analizë e rrymave filozofike dhe mënyrës së paraqitjes së tyre në poezinë shqipe veçanërisht ndërmjet dy luftrave botërore.
- Hapja e shtigjeve të reja për analizë më të hollësishme të ndikimit të filozofisë islame në mendimin qytetërimor shqiptar

Kontributet kryesore shkencore të kandidatit

Disa nga nëntitujt e këtij disertacioni mund të janë trajtuar nga studiues në punime shkencore të ndryshme, por rendësia e këtij disertacioni është përbledhja dhe analiza e tërësishme e metodologjisë filozofike islame dhe zgjatja e ndikimit të tyre në mendimin islam të përgjithshëm dhe veçanërisht nëatë shqiptarë. Si rrjedhojë, prej ku edhe mund të del një pasqyrë e qartë për ndikimet dhe mënyrën e mendimit dhe veprimit të autorëve shqiptarë.

Përmes shfrytëzimit të veprave autoriale, veprave origjinale të shkruara në lidhje me mendimin filozofik islam, shfrytëzimit revistave dhe literaturës relevante, punimeve dhe monografive në gjuhë të ndryshme, kandidati ka sjellë prurje të reja shkencore, të cilat janë një kontribut sa modest, po aq i çmuar në fushën e mendimit islam, mendimit qytetërimor shqiptar me theks të veçantë në ecurinë e filozofisë tek shqiptarët.

Si përfundim, vlerësojmë se kjo temë e disertacionit paraqet një kontribut të rendësishëm në pasqyrimin e pasurisë intelektuale dhe kulturore në përgjithësi në historinë e mendimit islam si dhe në antropologjinë kulturore të muslimanëve në përgjithësi, por edhe autorëve shqiptarë në veçati.

Hulumtime të mundshme të ardhshme

Disertacioni i doktoraturës “***NDIKIMI I FILOZOFISË ISLAME NË NDËRTIMIN E MENDIMIT QYTETËRIMOR SHQIPTAR***”, është temë specifike dhe brënda saj janë trajtuar tematika të ndryshme, kjo krijon mundësi për të qënë një bazë e mirë për hulumtime të ardhshme.

Kandidati është munduar që për të gjitha idetë dhe mendimet filozofike të autorëve shqiptarë të jep sqarime plotësuese të cilat mund shërbejnë për njohuri të reja jo vetëm në fushën e filozofisë islamë dhe ndikimit të saj në mendimin qytetërimor shqiptar pore dhe për kulturën intelektuale të përgjithshme ndër shqiptarët.

Vlerësojmë se punimet e këtilla janë me interes për zbardhjen e ideve dhe mendimeve origjinale të klasikëve qëjanë të pakta dhe si rrjedhojë pak të njohura në nënqiellin shqiptarë dhe mund të shërbejnë për zgjerimin dhe thellimin e studimeve të ardhshme. Veçanërisht përfundimi dhe rekonditimet e kandidatit paraqesin një shtytës efektiv për kahjen e zhvillimit të studimeve në të ardhmen.

Vlerësim dhe rekonditim

Nisur nga vlerësimet e sipërthëna Komisioni shkencor për vlerësimin e dorëshkrimit të temës së doktoraturës “**NDIKIMI I FILOZOFISË ISLAME NË NDËRTIMIN E MENDIMIT QYTETËRIMOR SHQIPTAR**”, të kandidatit Mr. Ramazan Fetahu, në përbërje të mëposhtme, ka nderin që ti propozoj Këshillit Mësimor –Shkencor të Fakultetit Filozofik miratimin e këtij raporti dhe të krijoj kushte për mbrojtjen publike të këtij disertacioni të doktoraturës.

Komisioni recenzues:

1. Prof. Dr. Kushtrim Ahmeti (Kryetar)
2. Prof. Dr. Sulejman Baki (anëtar)
3. Prof. Dr. Adnan Ismaili (anëtar)
4. Prof. Dr. Qani Nesimi (anëtar)
5. Prof. Dr. Metin Izeti (Mentor)

